

Akti Amerikan i Llogarive të Huaja për Pajtueshmëri Tatimore - FATCA

Akti Amerikan i Llogarive të Huaja për Pajtueshmëri Tatimore (FATCA) është zhvillim i rëndësishëm në përpjekjet e SHBA-ve për të luftuar evazionin fiskal nga personat me shtetësi amerikane që kanë investime në llogari jashtë vendit të tyre.

Sipas FATCA-s, taksapaguesit e caktuar të SHBA-ve që mbajnë pasuri financiare jashtë Shteteve të Bashkuara duhet t'i raportojnë ato pasuri në Shërbimin e të Hyrave të Brendshme – IRS. Po ashtu, FATCA do t'u kërkojë institucioneve të huaja financiare t'i raportojnë drejtpërdrejt IRS-së informata të caktuara rreth llogarive financiare që i mbajnë taksapaguesit e SHBA-ve, apo entitetet e huaja në të cilat taksapaguesit e SHBA-ve mbajnë interes të konsiderueshëm të pronësisë.

Personi duhet të trajtohet si i rëndësishëm sipas FATCA-s nëse njëra nga pikat më poshtë është e aplikueshme:

- Person me leje qëndrimi në SHBA apo shtetësi amerikane
- Person me adresë në SHBA
- Person i cili ka lindur në SHBA
- Person me adresë “in care of” apo “hold mail” që është e vetmja adresë e mbajtësit të llogarisë
- Person i cili i ka dhënë autorizimin një personi me adresë në Shtetet e Bashkuara të Amerikës
- Personi i cili ka udhëzim për të transferuar fonde në një llogari e cila mirëmbahet në Shtetet e Bashkuara apo udhëzime të marra nga një adresë në SHBA.